VENDIM
Nr. 242, datë 29.4.2025

MBI KRIJIMIN E NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, GJYKATAVE ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DHE GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 61, pika 2/ë, 94, pika 3 dhe 97, pika 1/c, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Krijimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si pjesë e strukturës organizative të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatave administrative të shkallës së parë, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Shërbimeve Juridike, Integrimit Evropian dhe Marrëdhënieve më Jashtë, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatat administrative të shkallës së parë, si dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi